



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	50-02
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	7937-2/25
Nr. I faqeve Broj. stranica No. pages	-05-
Data Datum Date	10.04.2026
PRISHTINË/A	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	03.04.2026
REFERENC-Ë:	25/7937/ MMPH
PËR/ZA/TO:	"Apa Com" Sh.p.k. Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr. prot.: 25/7937/678/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Apa Com" Sh.p.k. Pejë, për Fabrikën për prodhimin e kubëzave, pllakave dhe elementeve të betonit në Ramun, Komuna Pejë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 5



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitive ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Kompania "Apa Com" Sh.p.k. Pejë - **pajiset me Pëlqim Mjedisor** për veprimtarinë: për Fabrikën për prodhimin e kubëzave, pllakave dhe elementeve të betonit në Ramun, Komuna Pejë, në ngastrën kadastrale nr. P- 71611077-00179-7 në ZK Ramun Komuna e Pejës, nën kushtet si vijon:

- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit, si dhe të tëra sipërfaqet funksionale;
- Të vendoset sistemi për trajtimin e ujërave industriale dhe ujërave atmosferike të cilat krijohen në sipërfaqet operacionale gjatë të reshurave (sedimentuesit dhe separatori për ndarjen e derivateve dhe vajrave nga uji), para shkarkimit të tyre;
- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos së depos ku vendosën fuqitë e vajrave dhe derivateve, si dhe mbeturinat nga nusproduktet e krijuara gjatë procesit të prodhimit dhe larjes së auto mikserëve;

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë  
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: [zsp.mmph@ks-gov.net](mailto:zsp.mmph@ks-gov.net)



- Të bëhet monitorimi i përhershëm i filtrave të pluhurit, filtrat e dëmtuar të ndërrohen;
- Të bëhet mbyllja hermetike e gypave dhe kanaleve për përcjelljen (transportin) e çimentos dhe të izoloohen të gjitha pikat gjeneruese të pluhurit.
- Të bëhet monitorimi i emisioneve të pluhurit dhe ujërave që shkarkohen në mjedis;
- Rezultatet e kryera laboratorike të i raportohen MMPH-së;
- Të vendosen pajimet adekuate për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe lëngëta;
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terrenit dhe rregullimi i rrethojës së terrenit afër bazës së betonit;
- Të respektohet neni 48, pika 1 dhe 1.3 I Ligjit Nr.04/L-147 për Ujëra, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave;
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura t'i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk respektohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të merret (anulohet).

### A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar, nga Kompania "Apa Com" Sh.p.k. Pejë, për Fabrikën për prodhimin e kubëzave, pllakave dhe elementeve të betonit në Ramun, Komuna Pejë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me rekomandim të Komisionit për VNM, nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181.

**Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore**

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



Faqe 3 nga 5

**Vërejtje:** Tejkalimi i afatit të shqyrtimit është bërë shkak i emërimit të UD Sekretarit të ri dhe UD Drejtoreshës së re, si pasojë e së cilës është të ndryshohet data në dokument.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimet e të njejtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/7937/1 - ZSP/ /26 datë: 02.03.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Pejës
7. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
8. Divizionit për Komunikim me Publikun
9. Arkivit të MMPHI



Bajram Kafexholli

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

2. SHTOICË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### **Neni 31.**

#### Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

### **Neni 35.**

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

